

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Ndërmarrja Hidroekonomike Ibër Lepenc SH.A.

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: IL-26-2610-1-1-1

Sa i përket tenderit për : Furnizim me Gypa dhe Fazoneri - RITENDER

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Adetex Sh.p.k
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Muharrem Fejza P.n

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

+383 48142559

(Numri Telefonit)

10000

(Kodi postar)

(Numri i Faks-it)

AGIM FEKA

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Adetex.ks@gmail.com

(Adresa elektronike)

09.09.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe viza)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per vendimin e AK- RIVLERËSIM : 26.06.2026
Data e Kërkeses së dytë për rishqyrtim : 27.06.2026
Vendim per refuzimin e kërkesës për RISHQYRTIM_ Adetex SH.P.K..pdf : 29.06.2026
Vendimi i OSHP-së me nr. :OSHP 2026/0462 , OSHP:2026/0464: Data: 02.09.2026
B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK-së dhe Letrat Standarde pas Vendimit të OSHP-së - 07.09.2026
Kerkesa per Rishqyrtim pas vendimit te OSHP.pdf - 07.09.2026
Vendim per Refuzimin e kërkesës për RISHQYRTIM_ Adetex SH.P.K. pas RIVLERESIMIT VENDIMIT te OSHP.pdf - 08.09.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

NUK KEMI MARR PJESE NE HAPJEN E TENDERIT

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së.

Në përputhje me nenin 108/A të LPP-së, pas vendimit të OSHP-së me nr. :OSHP 2026/0462 , OSHP:2026/0464 ,Autoriteti Kontraktues nuk e ka zbatuar vendimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), përkatësisht nuk ka vepruar në përputhje me konstatimet dhe gjetjet e Panelit Shqyrtues të përcaktuara në vendim kështu duke e refuzuar Kërkesën tonë për rishqyrtim me datë : 08.09.2026

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Nenin 7 të LPP-së,
- Nenin 51 të LPP-së,
- Nenin 52 të LPP-së,
- Nenin 59 të LPP-së,
- Nenin 60 të LPP-së,
- Nenin 69 të LPP-së,

Shkeljet e REGULLORE PËR PROKURIMIN PUBLIK – Versioni i konsoliduar janë:

- Neni 25 Kriteret e përzgjedhjes të RrPP-së
- Neni 27 Kriteret e Dhënies së Kontratës të RrPP-së
- Neni 38 Sqarimi i Tenderëve të RrPP-së
- Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve të RrPP-së

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I nderuar Panel Shqyrtues i Prokurimit, pas VENDIMIT TË OSHP-së 2026/0462 , OSHP:2026/0464 te dates 02.09.2026

OE “ADETEX” SH.P.K. paraqet këtë ankesë kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues, me të cilin pas rivlerësimit është rekomanduar përsëri për kontratë OE “LURN” SH.P.K. Me datë 07.09.2026 kemi bërë Kërkese për Rishqyrtim ndaj vendimit të Autoritetit Kontraktues " Ndërmarrja Hidroekonomike Ibër Lepenc SH.A." ku është refuzuar Konsiderojmë se vendimi i ri i AK-së nuk është në përputhje me konstatimet e Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0462 dhe 2026/0464, për arsyt në vijim:

1. VENDIMI I OSHP-së thotë se lënda kthehet në Rivlerësim në bazë të ankesës së OE “ADETEX” SH.P.K. – nr.2026/0462

Kjo është veçanërisht e rëndësishme, sepse tregon se pretendimet e ngritura nga OE “ADETEX” SH.P.K. kanë qenë bazë për kthimin e procedurës në rivlerësim.

2. OE “LURN” SH.P.K. – mungesa e garancionit nga furnizuesi

Për OE “LURN” SH.P.K., Paneli Shqyrtues në VENDIMIN e tij ka konstatuar se nuk është plotësuar kërkesa e Dosjes së Tenderit për garancion minimum 24 muaj, të nënshkruar dhe vulosur nga furnizuesi.

Paneli nuk e ka pranuar që garancioni i prodhuesit të trajtohet si i barasvlershëm me garancionin e kërkuar nga furnizuesi dhe i ka dhënë të drejtë OE “ADETEX” SH.P.K. në këtë pretendim, duke konstatuar se OE “LURN” SH.P.K. nuk e përmbush këtë kërkesë të Dosjes së Tenderit rrjedhimisht oferta e OE “LURN “ SH.P.K është e pa përgjegjshme për këtë aktivitet të prokurimit.

3. OE “LURN” SH.P.K. – mungesa e përvojës në furnizime të ngjashme

OSHP ka trajtuar gjithashtu pretendimin e OE “ADETEX” SH.P.K. lidhur me referencat e OE “LURN” SH.P.K.

Nga 62 kontratat e paraqitura nga OE “LURN” SH.P.K., Paneli ka konstatuar se vetëm katër ishin kontrata furnizimi dhe asnjëra nuk ishte furnizim i ngjashëm apo i ndërlidhur me sistemet e ujitjes.

Për këtë arsye, Paneli e ka vlerësuar pretendimin e OE “ADETEX” SH.P.K. si të bazuar dhe ka konstatuar se OE “LURN” SH.P.K. nuk e plotëson kërkesën përkatëse të Dosjes së Tenderit, rrjedhimisht oferta e OE “LURN “ SH.P.K është e pa përgjegjshme për këtë aktivitet të prokurimit.

4. OE “XËRXA HIDRO GROUP” SH.P.K. – mungesa e garancionit nga furnizuesi

Edhe për OE “XËRXA HIDRO GROUP” SH.P.K., Paneli Shqyrtues ka konstatuar se nuk ishte dorëzuar garancioni i nënshkruar dhe vulosur nga furnizuesi, por garancioni i prodhuesit.

Edhe në këtë pikë, Paneli i ka dhënë të drejtë pretendimit të OE “ADETEX” SH.P.K. se OE “XËRXA HIDRO GROUP” SH.P.K. nuk e plotëson kërkesën përkatëse të Dosjes së Tenderit dhe rrjedhimisht oferta e OE “XËRXA HIDRO GROUP” SH.P.K është e pa përgjegjshme për këtë aktivitet të prokurimit.

5. Autoriteti Kontraktues “Ndërmarrjes Hidroekonomike “Ibër-Lepenc” SH.A -është i obliguar ta zbatojë vendimin e OSHP-së nr.2026/0462 dhe 2026/0464

OSHP ka konstatuar shkelje nga AK lidhur me dispozitat e LPP-së, përfshirë nenet 7, 59 dhe 108/A, dhe ka kthyer procedurën në rivlerësim duke kërkuar që AK t’u përmbahet në tërësi dispozitave ligjore dhe kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Prandaj, konsiderojmë se shpallja përsëri fitues e OE “LURN” SH.P.K., pa u adresuar dhe zbatuar në mënyrë substanciale konstatimet e OSHP-së për mangësitë e ofertës së këtij operatori, dhe operatorit “XËRXA HIDRO GROUP ” SH.P.K paraqet mosrespektim të vendimit të OSHP-së.

Moszbatimi apo mosrespektimi i një urdhri të OSHP-së nga AK mund të sjellë pasoja sipas LPP-së, përfshirë sanksione ndaj Autoritetit Kontraktues. Po ashtu, dhënia apo lidhja e kontratës në kundërshtim me një vendim ose urdhër të OSHP-së mund të prodhojë pasoja juridike edhe për vetë kontratën.

6. Moszbatimi i vendimit të OSHP-së

Theksojmë se vendimi i OSHP-së është obligativ për Autoritetin Kontraktues. Sipas nenit 131 të LPP-së, moszbatimi apo mosrespektimi i urdhrit të OSHP-së nga Autoriteti Kontraktues sanksionohet sipas ligjit në fuqi

Në rastin konkret, OSHP e ka kthyer lëndën në rivlerësim duke u bazuar në ankesën tonë nr. 2026/0462 dhe ka konstatuar mangësi konkrete në ofertën e OE “LURN” SH.P.K.dhe “XËRXA HIDRO GROUP ” SH.P. Prandaj, shpallja përsëri fitues e të njëjtit OE, pa u zbatuar në mënyrë substanciale këto konstatime, përbën bazë serioze për të konsideruar se vendimi i OSHP-së nuk është respektuar.

Me poshtë gjeni pjese nga Gjetjet e Panelit :

1.

efikasitetin. Unë si panelist ankesën e OE ankues Adetex nr. 2026/0462 e kualifikoj si të bazuar Lidhur me pretendimin e OE ankues kundrejt OE të rekomanduar për kontratë se i njëjti nuk përmbush kërkesën Dosjes së Tenderit për garancion të nënshkruar dhe vulosur nga furnizuesi. Duke u nisur nga kërkesa e Dosjes së Tenderit të kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale neni 9.1&9.2, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar shprehimisht: - “ Operatori Ekonomik duhet të ofroj autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për gypa “ - "Garancionin nga furnizuesi për produktet e ofruara, minimum 24 muaj nga data e liferimit." Ndërsa si: Dëshmi e kërkuar dokumentare : “Autorizim i nënshkruar dhe vulosur nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për gypa” "Garancioni i nënshkruar dhe vulosur nga furnizuesi." Si panelist nuk mund ta mbështesë ekspertin shqyrtues i cili e konfirmon qartë mungesën e një garancioni të nënshkruar dhe vulosur nga furnizuesi, dokument i cili ka qenë kërkesë e Dosjes së tenderit, me vetë faktin se këtë dokument e baras vlerëson me një dokument të OE të rekomanduar i cili ka dorëzuar garancion të lëshuar nga prodhuesi, gjë që nuk ka qenë kërkesë e Dosjes së Tenderit. Andaj, si panelist i jep të drejtë OE ankues se OE i rekomanduar nuk përmbushë këtë kërkesë të Dosjes së Tenderit dhe AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59.4 të LPP, duke bërë vlerësim të ofertave në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit, duke u nisur nga fakti se Dosja e tenderit ka bërë dallim për prodhuesin, distributorin e autorizuar dhe furnizuesin, kështu që Garancioni është kërkuar nga Furnizuesi në këtë rast ai i cili edhe do të jetë edhe nënshkruesi kontratës dhe i cili pastaj do të marr obligime të dala nga kjo kontratë dhe kjo kërkesë nuk është e vendosur si kërkesë e rastësishme nga ana e AK. Lidhur me pretendimin

2.

Tenderit. Lidhur me pretendimin tjetër të ankuesit se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe me parimet themelore të prokurimit publik, duke e konsideruar si të përgjegjshme ofertën e operatorit ekonomik XËRXA HIDRO GROUP Sh.p.k., ndonëse ky operator nuk e ka përmbyllur një kërkesë të detyrueshme të Dosjes së Tenderit. Nga dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik XËRXA HIDRO GROUP Sh.p.k. rezulton se është paraqitur vetëm një deklaratë garancioni (Warranty Statement) e lëshuar, nënshkruar dhe vëltur nga kompania Poliesther Cevi d.o.o., e cila është prodhuesi i mallrave, ndërsa nuk është dorëzuar garancioni i nënshkruar dhe vëltur nga vetë furnizuesi, respektivisht operatori ekonomik XËRXA HIDRO GROUP Sh.p.k.. Për më tepër, ndryshe nga dokumentacioni i operatorëve të tjerë, deklarata e garancionit e prodhuesit Poliesther Cevi d.o.o. nuk identifikon fare aktivitetin e prokurimit për të cilin pretendohet se është lëshuar. Në këtë dokument nuk figuron as titulli i aktivitetit të prokurimit "Furnizim me Gypa dhe Fazoneri – RITENDER" dhe as numri i prokurimit IL-26-2610-1-1-1, por dokumenti i referohet vetëm një Quotation No. 238-1/2026, pa e lidhur garancionin me aktivitetin konkret të prokurimit. Për pasojë, ky dokument nuk dëshmon në mënyrë të qartë dhe të pakontestueshme se është lëshuar pikërisht për këtë procedurë të prokurimit. Si panelist nuk mund ta mbështesë edhe këtë përgjigje të ekspertit shqyrtues e cila është aq boshe dhe e cila i ik komplet përgjigjes së mirëfilltë të këtij pretendimi ankimore. Andaj, si panelist i jep të drejtë OE ankues se XËRXA HIDRO GROUP Sh.p.k. nuk përmbyllë këtë kërkesë të Dosjes së Tenderit dhe AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59.4 të LPP, duke bërë vlerësim të ofertave në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit, duke u nisur nga fakti se Dosja e tenderit ka bërë dallim për prodhuesin, distributorin e autorizuar dhe furnizuesin, kështu që Garancioni është kërkuar nga Furnizuesi në këtë rast ai i cili edhe do të jetë edhe nënshkruesi kontratës dhe i cili pastaj do të merr obligime të dala nga kjo kontratë dhe kjo kërkesë nuk është e vendosur si kërkesë e rastësishme nga ana e AK. Po ashtu, ky garancion ka të meta sepse si i tillë përveç që nuk është dorëzuar garancioni i nënshkruar dhe vëltur nga vetë furnizuesi, respektivisht operatori ekonomik XËRXA HIDRO GROUP Sh.p.k. por është i nënshkruar dhe vëltur nga kompania Poliesther Cevi d.o.o., e cila është prodhuesi i mallrave, po ashtu, OE ankuesi ka të drejtë kur thotë se deklarata e garancionit e prodhuesit Poliesther Cevi d.o.o. nuk identifikon fare aktivitetin e prokurimit për të cilin pretendohet se është lëshuar. Në këtë dokument nuk figuron as titulli i aktivitetit të prokurimit "Furnizim me Gypa dhe Fazoneri – RITENDER" dhe as numri i prokurimit IL-26-2610-1-1-1, por dokumenti i referohet vetëm një Quotation No. 238-1/2026,

3.

nenin 56.3 të LPP dhe bie ndesh me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik. Unë si panelist ankesën e OE ankues XËRXA HIDRO GROUP Sh.p.k. nr. 2026/0464 e kualifikoj si pjesërisht të bazuar dhe lënda kthehet në ri-vlerësim vetëm duke u bazuar në ankesën 2026/0462. Kjo përshkak se OE XËRXA HIDRO GROUP Sh.p.k. në bazë të ankesës 2026/0462 rezulton se nuk e përmbyllë kërkesën e Dosjes së tenderit sa i përket ofrimit të garancionit nga furnizuesi.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Duke marrë për bazë të gjitha resurset njerëzore të angazhuar dhe pjesa teknike e logjistike dëmet materiale të cilat do të shkaktohen janë rreth 4200 Euro

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*